



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 872/24 Data: 10.05.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimit e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ.Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 122-të, mbajtur me datë 22.04.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Nuk riakreditohen programet e studimit të Universitetit të Prishtinës - Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë:
 1. *Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit, MSc 120 ECTS;*
 2. *Prodhim Shtazor, BSc 180 ECTS;*
 3. *Shkencat e Ushqimit, MSc 120 ECTS;*
 4. *Teknologji Ushqimore me Bioteknologji, BSc 180 ECTS;*
 5. *Ekonomi e Bujqësisë, BSc 180 ECTS;*
 6. *Shkencat e Aplikuara në Zootekni, MSc 120 ECTS dhe*
 7. *Mjekësi Veterinare, DMV 300 ECTS;*
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Universitetit të Prishtinës - Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë, ka parashtruar kërkesë Nr.Prot. 1502/23 e datës 31.10.2023 pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (tutje AKA), për riakreditimin e programeve të studimeve:

1. *Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit, MSc 120 ECTS;*
2. *Prodhim Shtazor, BSc 180 ECTS;*
3. *Shkencat e Ushqimit, MSc 120 ECTS;*
4. *Teknologji Ushqimore me Bioteknologji, BSc 180 ECTS;*
5. *Ekonomi e Bujqësisë, BSc 180 ECTS;*
6. *Shkencat e Aplikuara në Zootekni, MSc 120 ECTS dhe*
7. *Mjekësi Veterinare, DMV 300 ECTS;*

Pas aprovimit të aplikacionit, IAL ishte informuar nga AKA për vazhdimin e procedurave të riakreditimit të programeve sipas legjislacionit në fuqi, përkatësisht Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22).

Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë brenda afatit ligjor kishte parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit, MSc 120 ECTS;</i>	Iliriana Miftari Nijazi Bytyqi
2.	<i>Prodhim Shtazor, BSc 180 ECTS;</i>	Muhamet Kamberi Alltane Kryeziu Skender Muji
3.	<i>Shkencat e Ushqimit, MSc 120 ECTS</i>	Arbenita Hasani-Rexhepi Rreze Gecaj
4.	<i>Teknologji Ushqimore me Bioteknologji, BSc 180 ECTS;</i>	Xhavit Ramadani Salih Salihu Driton Sylejmani
5.	<i>Ekonomi e Bujqësisë, BSc 180 ECTS;</i>	Arben Musliu Jehona Shkodra, Prespa Ymeri Fatos Krasniqi
6.	<i>Shkencat e Aplikuarra në Zootekni, MSc 120 ECTS;</i>	Bajram Berisha Blerta Mehmedi Kastrati
7.	<i>Mjekësi Veterinare, DMV 300 ECTS;</i>	Agim Rexhepi Behlul Behluli Izedin Goga Afrim Hamidi Fatgzim Latifi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë të Universitetit të Prishtinës.

Vizitat janë organizuar më 28 dhe 29 Mars 2024, me ekspertët ndërkombëtarë me këtë përbërje: Reiner Doluschitz, Joachim Muller, Kiriaki Zinoviadou, Jasna Novak, Luc Hittinger, Jadranka Pelikan dhe Matej Drobnic.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit:** *Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit, MSc 120 ECTS*, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht gjashtë (6) dhe nuk e përmbush një (1). Meqenëse fusha e infrastrukturës për këtë program studimi nuk është përmbushur, dhe kjo fushë është e detyrueshme të plotësohet së paku në nivel substancial sipas Manualit për Akreditim, rekomandimi i ekspertëve ndërkombëtar është që ky program të mos akreditohet derisa objekti i ri të kompletohet dhe të jetë i shfrytëzuar.

2. **Për programin e studimit:** *Prodhim Shtazor, BSc 180 ECTS*, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht gjashtë (6) dhe nuk e përmbush një (1). Meqenëse fusha e infrastrukturës për këtë program studimi nuk është përmbushur, dhe kjo fushë është e detyrueshme të plotësohet së paku në nivel substancial sipas Manualit për Akreditim, rekomandimi i ekspertëve ndërkombëtar është që ky program të mos akreditohet derisa objekti i ri të kompletohet dhe të jetë i shfrytëzuar.
3. **Për programin e studimit:** *Shkenca e Ushqimit, MSc 120 ECTS*, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht gjashtë (6) dhe nuk e përmbush një (1). Meqenëse fusha e infrastrukturës për këtë program studimi nuk është përmbushur, dhe kjo fushë është e detyrueshme të plotësohet së paku në nivel substancial sipas Manualit për Akreditim, rekomandimi i ekspertëve ndërkombëtar është që ky program të mos akreditohet derisa objekti i ri të kompletohet dhe të jetë i shfrytëzuar.
4. **Për programin e studimit:** *Teknologji Ushqimore me Bioteknologji, BSc 180 ECTS*, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht gjashtë (6) dhe nuk e përmbush një (1). Meqenëse fusha e infrastrukturës për këtë program studimi nuk është përmbushur, dhe kjo fushë është e detyrueshme të plotësohet së paku në nivel substancial sipas Manualit për Akreditim, rekomandimi i ekspertëve ndërkombëtar është që ky program të mos akreditohet derisa objekti i ri të kompletohet dhe të jetë i shfrytëzuar.
5. **Për programin e studimit:** *Ekonomi e Bujqësisë, BSc 180 ECTS*, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht gjashtë (6) dhe nuk e përmbush një (1). Meqenëse fusha e infrastrukturës për këtë program studimi nuk është përmbushur, dhe kjo fushë është e detyrueshme të plotësohet së paku në nivel substancial sipas Manualit për Akreditim, rekomandimi i ekspertëve ndërkombëtar është që ky program të mos akreditohet derisa objekti i ri të kompletohet dhe të jetë i shfrytëzuar.
6. **Për programin e studimit:** *Shkenca e Aplikuar në Zootekni, MSc 120 ECTS*, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht gjashtë (6) dhe nuk e përmbush një (1). Meqenëse fusha e infrastrukturës për këtë program studimi nuk është përmbushur, dhe kjo fushë është e detyrueshme të plotësohet së paku në nivel substancial sipas Manualit për Akreditim, rekomandimi i ekspertëve ndërkombëtar është që ky program të mos akreditohet derisa objekti i ri të kompletohet dhe të jetë i shfrytëzuar.
7. **Për programin e studimit:** *Mjekësi Veterinare, DMV 300 ECTS*, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht gjashtë (6) dhe nuk e përmbush një (1). Meqenëse fusha e infrastrukturës për këtë program studimi nuk është përmbushur, dhe kjo fushë është e detyrueshme të plotësohet së paku në nivel substancial sipas Manualit për Akreditim, rekomandimi i ekspertëve ndërkombëtar është që ky program të mos akreditohet derisa objekti i ri të kompletohet dhe të jetë i shfrytëzuar.

Bazuar në këtë raport të cekur më lartë, referuar Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22), ku në paragrafin II të vendimit për plotësim/ndryshimin e manualit i cili më pas është bërë pjesë përbërëse e manualit, thuhet, citojmë: **”Në standardet e vlerësimit për programet e studimit në nivel Bachelor dhe Master, Kapitulli 2, nënkapitulli 2.2 paragrafi 3, i cili i referohet Stafit akademik, dhe paragrafi 7 i cili i referohet Infrastrukturës dhe pajisjeve, janë obligativ. Programet e studimit në nivel Bachelor apo Master nuk mund të rekomandohen për akreditim derisa nuk kanë përmbushur në mënyrë substanciale apo të plotë të dy këto fusha të përgjithshme.”**

Gjatë vlerësimit, ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit në raport kanë konstatuar se fushën e standardeve obligative që i referohet Infrastrukturës dhe pajisjeve, Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë përmbushë vetëm pjesërisht, e që sipas manualit përmbushja e fushave të tjera nuk mjafton për akreditimin e programit.

Andaj bazuar në dispozitat ligjore dhe raportet e ekspertëve të cekura më lartë KShC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala mund të parashtroj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Vendimi i dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.




Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shpërndarës të Çështjes